



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

të mbledhjes së tretë të Kuvendit të Kryeqytetit të Republikës së Kosovës, mbajtur më 28.4.2026, e cila filloi në orën 10:00.

Në mbledhje morën pjesë: Fehmi Kupina (Lidhja e Prishtinës) - kryesues i Kuvendit, Bekim Gashi (LDK), Milazim Vitija (LDK), Fadil Aliu (LDK), Egzon Pacolli (LDK), Dasmor Durmishi (LDK), Etnik Mustafa (LDK), Shefqet Osmani (LDK), Donjeta Dragusha (LDK), Dhurata Jahaj-Retkoceri (LDK), Lindita Rexhepi- Osmani (LDK), Rifadije Sopi (LDK), Amir Simnica (LDK), Pëllumb Bajçinovci (LDK), Kushtrim Sopa (LDK), Fiknete Bejta (LDK), Agron Canolli (PDK), Leutrim Retkoceri (PDK), Besianë Musmurati (PDK), Ilirik Musliu (PDK), Yll Muriqi (PDK), Granit Geci (PDK), Florian Beka (PDK), Kumrije Shabani- Ramadani (PDK), Plator Gërdovci (PDK), Arbnora Ajeti (PDK), Fjolla Vukshinaj- Reçica (PDK), Trim Sylja (PDK), Mrika Limani- Myrtaj (LVV), Gëzim Sveçla (LVV), Jeta Dida- Bujari (LVV), Berita Abazi- Muhadri (LVV), Çlirim Gërbeshi (LVV), Feim Osmani (LVV), Nora Kelmendi (LVV), Besart Krasniqi (LVV), Nexhmije Gjema (LVV), Lumniqe Mikullovc (LVV), Leonora Shabani- Bajraktari (LVV), Enver Redenica (LVV), Kreshnik Smajlaj (AAK), Endrit Gashi (AAK), Erblina Tahiraj (AAK), Betim Abdullahu (Lidhja e Prishtinës), Arbenita Murseli- Haxholli (Lidhja e Prishtinës), Teuta Kadiu- Gjinolli (Lidhja e Prishtinës), Besa Shahini (PSD), Endrit Zabërgja (NISMA), Jeton Mehmeti (GUXO), Valbona Ajeti (AAK), Yll Bogaj (i pavarur).

Të pranishëm ishin edhe: Përparim Rama – Kryetar i Kryeqytetit, Florian Dushi- nënkryetar i Komunës, Valbona Makolli - drejtore e Drejtorisë së Financave, Arbër Sadiki - drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, Gëzim Kastrati - drejtor i Drejtorisë së Transformimit, Luftar Braha - drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Brahim Mehmetaj - drejtor i Drejtorisë së Pronës, Bujar Gashi - drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë, Donat Lushaku – drejtor i Drejtorisë së Mobilitetit, Sokol Havolli - drejtor i Drejtorisë së Investimeve Kapitale, Adelina Sahiti - drejtore e Drejtorisë së Mirëqenies Sociale, Donika Çetta – drejtore e Drejtorisë së Parqeve, Jeta Rafuna – drejtore e Drejtorisë së Bujqësisë, Rrezarta Aliu – drejtore e Drejtorisë së Turizimit, Driton Bardheci- drejtor i Drejtorisë së Administratës, Samir Shahini – drejtor i Drejtorisë së Arsimit, Gent Begolli, drejtor i Drejtorisë së Kadastrit, Donat Gashi – drejtor i Drejtorisë së Rinisë, Bekim Brestovci - drejtor i Drejtorisë së Inspeksionit, Kushtrim Mushica - drejtor i Drejtorisë së Sportit, përfaqësues të OSBE-së dhe të medieve.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Fehmi Kupina**, kryesues i Kuvendit.

Kryesuesi para se të fillonte me diskutimet për rendin e ditës, njoftoj ndryshimet në përbërjen e Kuvendit. Bujar Gashi zëvendësohet me anëtarin Kushtrim Sopa dhe Jeta Rafuna-Hasani zëvendësohet me Fiknete Bejtën, të cilët bënë betimin solemn dhe

zyrtarisht morën detyrën si anëtarë të Kuvendit të Komunës. Ai poashtu njoftoj për ndryshimin lidhur me anëtarin Yll Bogaj, i cili nga radhët e AAK-së kalon si anëtarë i pavarur.

Kryesusi vazhdon mbledhjen me këtë

Rend dite:

- 1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të seancës së jashtëzakonshme të Kuvendit të Kryeqytetit;**
- 2. Propozim-vendimi për miratimin e Planit të veprimit për shërbime sociale 2026 - 2028;**
- 3. Propozim-vendimi për plotësim-ndryshimin e Vendimit të Komitetit për politikë dhe financa;**
- 4. Propozim-vendimi për lënie në diskutim publik për ndryshime dhe plotësime të Rregullores, nr. 01-110/1205 K.Pr, për shërbimin e transportit me merimangë për territorin e komunës së Prishtinës;**
- 5. Propozim-vendimi për lënie në diskutim publik për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores, nr. 01-030/ 01-236535/23 K.Pr për organizimin dhe shfrytëzimin e parkingjeve të komunës së Prishtinës;**
- 6. Raporti konsolidues i performancës financiare dhe operative të ndërmarrjes “Prishtina Parking”;**
- 7. Propozim-vendimi për subvencionimin e NPL “Prishtina Parking”;**
- 8. Raporti financiar buxhetor i Kryeqytetit, TM1 2026;**
- 9. Propozim-vendimi për bartjen e mjeteve nga viti 2025 në vitin 2026;**
- 10. Propozim-vendimi për lënie në diskutim publik për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për menaxhimin e varrezave dhe objektit komemorativ në komunën e Prishtinës;**
- 11. Pyetje dhe përgjigje.**

Brahim Mehmetaj propozoi që në rend të ditës të përfshihen këto pika: Propozim-vendimi për dhënien në shfrytëzim të pjesëve të parcelave kadastrale, nr. P -71914059-06118-1 dhe P-71914059-06119-3, për NP “Termokos”, SHA; Propozim-vendim për dhënien në shfrytëzim të një pjese të parcelës kadastrale, nr. P -71914059-07090-21, për NP “Termokos”, SHA; dhe Propozim-vendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës për “Muzeun e të Mbijetuarve të Dhunës Seksuale Gjatë Luftës në Kosovë”, i themeluar dhe menaxhuar nga “Fondacioni Jahjaga”.

Samir Shahini propozoi si pikë të rendit të ditës: Propozim-vendimi për bartjen e normave aktuale nga niveli i arsimit të mesëm të lartë dhe niveli i mesëm i ulët në nivelin parafillor.

Gëzim Sveçla foli për shqetësimin e një grup qytetarësh që ndodheshin para objektit të Komunës, që kishin shprehur interes për të marrë pjesë në mbledhje. Ai tha se, sipas informatave, kryesuesi i Kuvendit ua ka refuzuar pjesëmarrjen, gjë që bie ndesh me Ligjin për vetëqeverisje lokale, i cili parasheh që mbledhjet e Kuvendit komunal të jenë të hapura për qytetarë. Prandaj, kërkoj që ata të lejohen të marrin pjesë, për aq kohë sa nuk pengojnë mbarëvajtjen e mbledhjes. Sveçla propozoi gjithashtu që në rend dite të përfshihen diskutimi për situatën me mbeturinat në Prishtinë dhe gjendjen në Ndërmarrjen Publike Banesore, pas një vendimi të Gjykatës. Ai i bëri thirrje edhe kryetarit që të qëndrojë deri në fund të mbledhjes, pasi në dy seancat e kaluara kanë mbetur vetëm dy ose tre drejtorë deri në përfundim të mbledhjes.

Kryesuesi bëri të ditur se në zyrën e tij ka biseduar me ata qytetarë dhe i ka përcjellë shqetësimet e tyre, prandaj nuk e sheh të arsyeshme që ata të jenë sot të pranishëm në mbledhje.

Betim Abdullahu propozoi që pika dymbëdhjetë e rendit të ditës, “Të ndryshme”, të jetë pika parë e rendit të ditës, për arsye se kur po diskutohet për kërkesat e qytetarëve, shumica e drejtorëve nuk po janë të pranishëm dhe pastaj nuk po mund t’i adresojmë direkt te secili drejtor.

Egzon Pacolli propozoi që propozim-vendimi për plotësimin e ndryshimit të Vendimit të Komitetit për Politikë dhe Financa të largohet si pikë e rendit të ditës.

Feim Osmani kërkoj të diskutoj lidhur me shqetësimin paraprak, që ka të bëjë me përgjigjen e kryesuesit lidhur me mos lejimin e qytetarëve në seancë. Osmani tha se nuk mjafton fakti se ti si kryesues ke biseduar me ta, sepse shqetësimet e tyre mund të jenë të lidhura me kryetarin apo ndonjë drejtor të specifikisht. Ai tha se pavarësisht kësaj, nuk kemi të drejtë asnjë nga ne dhe as ju si kryesues, t’ua mohoni të drejtën e tyre për pjesëmarrje, gjë e cila ju garantohet me rregullore dhe me ligj.

Rifadije Sopi tha se në emër të grupit të grave të Asamblesë, kemi një pikë, e cila mendojmë se duhet të diskutohet, e ajo është: “Deklaratë për eliminimin e të gjitha formave të dhunës ndaj grave në politikë dhe jetën publike”.

Leutrim Retkoceri kërkoj sqarim lidhur me funksionalizimin e Komisionit për emërtimin dhe rifreskimin e listës së rrugëve, rrugicave dhe vendeve publike, si dhe Komisionit për formimin dhe zgjedhjen e këshillave lokale në Kryeqytet. Ai tha se qytetarët kanë kërkesa të shumta dhe duan të dinë nëse këto komisione janë ende funksionale apo u ka përfunduar mandati. Retkoceri lidhur me pikat e propozuara për rend dite, tha se do të ishte më e drejtë që paraprakisht të sigurohet materiali përkatës, në mënyrë që të dihet saktësisht për çfarë po diskutohet.

Egzon Pacolli propozoi këtë pikë të rendit të ditës: Propozim-vendimi për emërimin e aksionarëve të ndërmarrjeve publike lokale: “Termokos”, “Trafiku Urban”, “Sport Marketing”, “Kuzhina Qendrore”, “Stacioni i Autobusëve” dhe “Pallati i Rinisë”.

Nora Kelmendi, lidhur me pikën e propozuar: “Deklaratë për eliminimin e të gjitha formave të dhunës ndaj grave në politikë dhe jetën publike”, propozoj që të hyjë si pikë e rendit të ditës dhe të votohet.

Rifadije Sopi u shpreh e pajtimin me propozimin e koleges Nora, por paraprakisht ta kemi si pikë në rend të ditës, pastaj ta marrim një interpretim nga Zyra ligjore se a duhet ta votojmë edhe si pikë apo jo.

Kryesuesi konstatoi se propozimi për pikë të rendit të ditës nga drejtori Ibrahim Mehmetaj, "Propozim-vendim për dhënien e pronës së paluajtshme në shfrytëzim të pjesëve të parcelave kadastrale, nr. P-71914059-0118-1 dhe P-71914059-06119-3 për NP "Termokos", SHA", kalon me 32 vota për, 2 kundër dhe 1 abstenim.

Kryesuesi konstatoi se propozimi për pikë të rendit të ditës nga drejtori Ibrahim Mehmetaj, "Propozim-vendim për dhënien e pronës së paluajtshme në shfrytëzim të një pjese të parcelës kadastrale, nr. P-71914059-07090-21 për NP "Termokos", SHA", kalon me 28 vota për, 1 kundër dhe asnjë abstenim.

Kryesuesi konstatoi se propozimi për pikë të rendit të ditës nga drejtori Ibrahim Mehmetaj, "Propozim-vendim për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës për "Muzeun e të Mbijetuarve të Dhunës Seksuale Gjatë Luftës në Kosovë" i themeluar dhe menaxhuar nga "Fondacioni Jahjaga", kalon me 34 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim.

Kryesuesi konstatoi se propozimi për pikë të rendit të ditës nga drejtori Samir Shahini, "Propozim-vendim për bartjen e normave aktuale nga niveli i arsimit të mesëm të lartë dhe niveli i arsimit të mesëm në nivelin e ulët fillor", kalon me 33 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim.

Kryesuesi konstatoi se propozimi për pikë të rendit të ditës nga Gëzim Sveçla, "Diskutim mbi situatën e krijuar të mbeturinave në Kryeqytet", kalon me 22 vota për, 20 kundër dhe asnjë abstenim.

Kryesuesi konstatoi se propozimi për pikë të rendit të ditës nga Gëzim Sveçla, "Diskutim mbi gjendjen në Ndërmarrjen Publike Banesore NPB", kalon me 20 vota për, 19 kundër dhe asnjë abstenim.

Kryesuesi konstatoi se propozimi nga Betim Abdullahu, që pika e dymbëdhjetë e rendit të ditës të kalojë si pikë e parë, pas miratimit të ekstraktit të procesverbalit, kalon me 23 vota për, 11 kundër dhe asnjë abstenim.

Kryesuesi konstatoi se propozimi për pikë të rendit të ditës nga Egzon Pacolli, "Propozim-vendim për emërimin e aksionarëve të ndërmarrjeve publike lokale, "Termokos", "Trafiku Urban", "Sport Marketing", "Kuzhina Qëndrore", "Stacioni i Autobusëve" dhe Pallati i Rinisë", kalon me 29 vota për, 13 kundër dhe 1 abstenim.

Kryesuesi konstatoi se propozimi për pikë të rendit të ditës nga Rifadije Sopi, "Deklaratë për eliminimin e të gjitha formave të dhunës ndaj grave në politikë dhe jetën publike", kalon me 46 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim.

Kryesuesi konstatoi se më 39 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, miratohet rendi i ditës me ndryshime.

Kryesuesi konstatoi se më 40 vota për, asnjë kundër dhe një abstenim, miratohet ekstrakti i procesverbalit të seancës së jashtëzakonshme të Kuvendit të Kryeqytetit.

Pika e dytë e rendit të ditës.

“Të ndryshme”;

Leonora Shabani kërkoi disa informata lidhur me trajtimin e fëmijëve me nevoja të veçanta në komunën e Prishtinës, nga drejtori i Arsimit për numrin e asistentëve të punësuar, me ç’rast ngriti shqetësimin se, megjithëse asistentët kanë kontrata për 30 orë pune në javë, në listat e pagave u deklarohen vetëm 20 orë pune. Po ashtu, pyeti nëse DKA-ja ka kryer ndonjëherë inspektim ndaj asistentëve dhe nëse komisioni i ri vlerësues ka filluar punën. Në fund, ajo kërkoi sqarime pse disa fëmijë me nevoja të veçanta përfitojnë pagesën e transportit sipas ligjit, ndërsa disa të tjerë jo?!

Jeta Dida-Bujari foli për shqetësimet e banorëve të lagjes “Velania” për infrastrukturën rrugore, mungesën e ndriçimit publik, asfaltimin e papërfunduar të rrugës “Tonin Harapi” dhe paqartësitë rreth punimeve prapa “SOS” fshatit. Ajo kërkoi vendosjen e semaforëve, policëve të shtrirë, sinjalistikës dhe tabelave të rrugëve, si dhe rregullimin e qarkullimit të mjeteve të rënda. Po ashtu, theksoi nevojën për më shumë investime në gjelbërim, mirëmbajtje dhe përmirësim të transportit publik. Dida-Bujari ngriti shqetësimet e banorëve të Ulpianës, në rrugën “Egnatia”, për mungesën e menaxhimit të parkimit nga “Prishtina Parking”, mungesën e infrastrukturës dhe uzurpimin e hapësirave publike nga biznese private. Ajo kërkoi sqarime dhe masa konkrete nga Komuna për rregullimin e parkimit dhe lirin e hapësirave publike.

Enver Redenica ngriti shqetësime për menaxhimin e qenve endacakë dhe shpenzimet e Komunës për strehimin dhe trajtimin e tyre, duke pyetur pse ende mungon një zgjidhje konkrete. Ai kërkoi edhe masa për kontrollin e qenve shtëpiakë në hapësira publike, përfshirë vendosjen e maskave mbrojtëse. Ai theksoi mungesën e vijave të bardha për këmbësorë në rrugët “Muj Krasniqi”, “Zija Shemsiu” dhe “Edmond Hoxha” në Ulpianë, duke e konsideruar këtë rrezik për nxënësit dhe banorët. Redenica kritikoi mosrealizimin e premtimit për trafik urban në Prapashticë, në rrugën “Krenaria e Gollakut” deri në Motivod, dhe kërkoi funksionalizimin e linjës së autobusit për banorët e zonës.

Nexhmije Gjema foli lidhur me sigurinë dhe etikën në shkolla. Ajo përmendi dy raste serioze në shkollën “Dardania”, ku nxënës janë kapur me armë, duke pyetur nëse Drejtoria e Arsimit është njoftuar zyrtarisht dhe çfarë masash janë ndërmarrë. Po ashtu, ngriti shqetësimin për përdorimin dhe shpërndarjen e substancave narkotike në shkolla, duke kërkuar masa konkrete për rritjen e sigurisë dhe bashkëpunimit me policinë. Gjema kritikoi praktikën e mbledhjes së parave për dhurata të shtrenjta për mësimdhënësit, duke theksuar presionin dhe pabarazinë që kjo krijon tek nxënësit. Në fund ceku edhe shqetësimet e prindërve lidhur me ekskursionet shkollore, ku sipas pretendimeve, po konsumohet alkool nga nxënësit dhe mungon reagimi adekuat i stafit mbikëqyrës.

Besart Krasniqi përmendi punimet në rrugën “Bajram Curri” në lagjen “Arbëria”, ku qytetarët po shprehin shqetësime për sigurinë, lëvizjen e dheut dhe largimin e gjelbërimit. Ai ngriti problemin e vonësive të pagave për punëtorët teknikë në shkollat e Prishtinës, duke kërkuar zgjidhje të qëndrueshme për këtë çështje. Po ashtu, kërkoi vendosjen e një stacioni të rregullt për linjën e autobusit nr. 28 në Miloshevë, për shkak të mungesës së sinjalizimit dhe rrezikut për qytetarët. Krasniqi kërkoi asfaltimin e një rrugice, rreth 500 metra, në fshatin Sharban, që lidhet me rrugën “Martirët”. Në fund, foli për shqetësimin e banorëve të lagjes “Kodra e Trimave” në rrugën “Muharrem Mehmeti”, ku kërkohet vendosja e shenjës “ndalim parking” për të shmangur bllokimin e rrugës dhe pamundësimin e qasjes për kamionët e pastrimit.

Betim Abdullahu foli lidhur me gjendjen infrastrukturore në Vranidoll, duke theksuar problemet me ujërat atmosferike dhe mungesën e reagimit nga Komuna edhe pas diskutimeve të mëparshme, kërkoi ndërhyrje konkrete dhe vizitë në terren nga ekipet komunale. Abdullahu foli për çështjen e fushës së klubit futbollistik “Barileva”, duke akuzuar Drejtorinë e Pronës për refuzim të padrejtë të kërkesës për shfrytëzim të hapësirës, e cila përdoret nga mbi 300 fëmijë të zonës së Llapit për stërvitje futbollit. Ai theksoi mungesën dhe problemet me ndriçimin publik në Vranidoll dhe Siqevë.

Feim Osmani kërkoi sqarime nga Drejtoria e Arsimit lidhur me projektin dhe lejen e ndërtimit të shkollës “Nexhmi Mustafa” në Besi, duke theksuar se mjetet janë zotuar nga Ministria e Arsimit, por projekti ende nuk ka filluar. Osmani foli lidhur me çështjen e mospagesës së mëditjeve për kryetarët e këshillave lokale, ndonëse kjo është e paraparë me rregullore të Kuvendit. Poashtu, ai kërkoi nga Drejtoria e Administratës dhe Kryesuesi i Kuvendit përgatitjen e materialit për formimin e Komisionit për zgjedhjen dhe monitorimin e këshillave lokale, pasi disa bashkësi lokale kanë mbetur të pakonsoliduara dhe disa kryetarë kanë dhënë dorëheqje.

Lumnije Mikullovci foli lidhur me trafikun urban dhe qasjen për qytetarët, duke theksuar se reklamat në autobusë ua vështirësojnë udhëtarëve orientimin dhe identifikimin e stacioneve, veçanërisht në orët e mbrëmjes, për çka ka pranuar ankesa të shumta nga qytetarët, sidomos nga personat e verbër, të cilët kanë kërkuar instalimin e sistemit zanor në autobusë për paralajmërimin e stacioneve, vendosjen e vijave orientuese për shkopin e bardhë në hapësira publike dhe funksionalizimin e semaforëve me sinjalizim zanor. Ajo paraqiti propozim për krijimin e një skene verore për aktivitete kulturore dhe artistike gjatë sezonit veror, me qëllim gjallërimin e jetës kulturore, promovimin e artistëve vendorë dhe forcimin e lidhjes me diasporën. Ai propozoi që skena të vendoset në një hapësirë publike dhe të funksionojë gjatë muajve të verës me aktivitete të organizuara.

Nora Kelmendi foli për shqetësimin e banorëve të lagjes “Arbëria”, respektivisht rrugës “Vicianum” dhe rrugës “Kasëm Haxhimurati”, lidhur me grumbullimin e mbeturinave, veçanërisht atyre inerte, të cilat sipas saj nuk janë larguar prej muajsh, dhe kërkoi nga Komuna e Prishtinës dhe ndërmarrja “Pastrimi” ndërmarrjen e masave urgjente për pastrimin e lokacionit, duke theksuar se qytetarët e kontaktojnë vazhdimisht për këtë problem. Poashtu ajo foli edhe për gjendjen infrastrukturore në rrugën “Hyzyri Talla” në lagjen “Bregu i Diellit”, duke përmendur gropat në rrugë, kanalizimet e bllokuara, gjendjen e rënduar të shkallëve të lagjes dhe mungesën e gjelbërimit. Nora propozoi rregullimin e hapësirës prapa ndërtesave përballë Fakultetit Teknik për park dhe organizimin e parkingut të përbashkët të banorëve.

Besa Shahini foli për sigurinë në komplekset banesore, duke iu referuar rastit të djegies së një ndërtese në Tiranë, si pasojë e mbeturinave ambalazhuese të marketeve. Ajo theksoi se në Prishtinë shumë markete në komplekse banesore lënë mbeturina para hyrjeve të ndërtesave, duke paraqitur rrezik për sigurinë dhe higjienën publike. Prandaj, kërkoj nga drejtoritë përkatëse ndërmarrjen e masave urgjente, përfshirë njoftimin dhe gjobitjen e marketeve që lënë mbeturina para hyrjeve të ndërtesave. Znj.Shahini kërkoj ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Shërbime Publike, të vitit 2010, me qëllim të përfshirjes së dispozitave më specifike për menaxhimin e hapësirave publike dhe trajtimin e mbeturinave nga marketet.

Gëzim Sveçla foli për raportin e auditimit për vitin 2024 dhe kërkoj sqarime nga kryetari lidhur me transferimin e shumës prej 5,120,000 euro tek UNDP, si parapagim për dy projekte, duke theksuar se raporti i auditimit e konsideron këtë veprim në kundërshtim me Ligjin për Prokurim dhe Ligjin për Buxhetin, si dhe pa vendim të Kuvendit komunal. Poashtu, ai ngrii çështjen e kontratës për projektimin e objektit në hapësirën “Tullëtorja”, në vlerë prej 1,200,000 euro, duke theksuar se, sipas raportit të auditimit, kjo kontratë është dhënë përkundër ekzistimit të kontratës aktive me “Arkitektin e Kryeqytetit” dhe në kundërshtim me ligjet e aplikueshme. Ai kërkoj sqarime nga kryetari Rama lidhur me pretendimet për shlyerjen e një borxhi prej 2,400,000 euro në Angli, bazuar në të ardhurat e deklaruara.

Fjolla Vukshinaj foli për dëmet nga vërshimet e ndodhura më 4, 5 dhe 6 janar në fshatin Vranidoll, dhe falënderoi Drejtorinë e Emergjencave për daljen në terren dhe hartimin e raportit, i cili sipas saj i është dërguar Drejtorisë së Investimeve Kapitale. Ajo tha se i ka dërguar tri kërkesa me e-mail drejtorit Sokol Havolli, por nuk ka marrë përgjigje, dhe kërkoj sqarim se kur do të fillojnë intervenimet në këtë zonë. Znj.Vukshinaj tha se nevoja për intervenim është urgjente në rrugën pranë shkollës “Nënë Tereza”, që lidh zonën me malin, ndërsa shprehu gatishmëri për dalje të përbashkët në terren për identifikimin e lokacionit.

Pika e tretë e rendit të ditës.

“Propozim-vendimi për emërimin e aksionarëve të ndërmarrjeve publike lokale, “Termokos”, “Trafik Urban”, “Sport Marketing”, “Kuzhina Qendrore”, “Stacion i Autobusëve” dhe “Pallati i Rinisë”.

Egzon Pacolli propozoi këta anëtarë të Kuvendit për aksionarë në ndërmarrjet publike lokale: “Termokos”, SHA – Egzon Pacolli dhe Bekim Gashi, “Trafiku Urban”, SHA – Rifadije Sopi dhe Lindita Rexhepi, “Sport – Marketing”, SHA – Pëllumb Bajçinovci dhe Driton Rukiqi, “Kuzhina Qendrore”, SHA – Dasmor Durmishi dhe Donjeta Dragusha.

Arbenita Murseli-Haxholli propozoi Arian Shabanaj dhe Sabri Dragusha për aksionarë në Ndërmarrjen Publike Lokale, “Pallati i Rinisë” SHA.

Kreshnik Smajlaj propozoi Kreshnik Smajlaj dhe Shkëlqim Osmanaj për aksionarë në ndërmarrjen publike lokale, “Stacioni i Autobusëve” SHA.

Gëzim Sveçla shprehu shpresën që aksionarët e rinj, pas kalimit të procedurave dhe filtrave ligjorë, të ndryshojnë qasjen e deritanishme në menaxhimin e ndërmarrjeve publike dhe se

mungesa e mbikëqyrjes ka rezultuar me ndërmarrje pa aksionarë, borde me mandate të skaduara dhe punëtorë që punojnë në kushte të vështira dhe pa paga. Ai deklaroi se Lëvizja Vetëvendosje nuk do të propozojë aksionarë në këtë proces.

Çlirim Gërbeshi foli për menaxhimin e Stacioni i Autobusëve, duke krahasuar periudhat e udhëheqjes nga subjektet politike dhe se gjatë udhëheqjes nga Lëvizja Vetëvendosje janë realizuar rritje pagash prej 15% për punëtorët, janë ndarë bonuse vjetore dhe janë rritur të hyrat dhe fitimi i ndërmarrjes. Ai tha se ndërmarrjet publike kanë nevojë për menaxhim të mirë dhe kritikoi gjendjen në disa ndërmarrje të tjera publike në Prishtinë, duke përmendur probleme financiare dhe vonesa në pagesa për punëtorët.

Kryesuesi konstatoi se “Propozim-vendimi për emërimin e aksionarëve të ndërmarrjeve publike lokale: “Termokos”, “Trafik Urban”, “Sport Marketing”, “Kuzhina Qendrore”, “Stacion i Autobusëve” dhe “Pallati i Rinisë”, miratohet me njëzet e tetë vota për, trembëdhjetë kundër, katër absenime.

Pika e katërt e rendit të ditës, “Propozim-vendimi për miratimin e Planit të veprimit për shërbime sociale 2026-2028”.

Rifadije Sopi propozoi përfshirje të mbështetjes për personat shoqëruar të fëmijëve me aftësi të kufizuara, familjet me lindje të shumëfishta, krijimin e shërbimeve të përkohshme për kujdesin e personave të varur, këshillim pedagogjik falas, programe për të moshuarit që jetojnë vetëm, përfshirjen e fëmijëve nga familjet me asistencë sociale në programe praktike profesionale, si dhe programe për integrimin e viktimave të dhunës në familje. Ajo poashtu propozoi zhvillimin e programeve për shëndetin mendor në komunitet, mbështetje për personat me shurdhësi përmes trajnimit të stafit në gjuhën e shenjave, digjitalizimin e aplikimeve për ndihmë sociale, subvencionimin e qirasë për familjet në nevojë, krijimin e qendrave ditore për të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara, si dhe mbështetje të veçantë për prindërit vetushqyes.

Ilirik Musliu falënderoi Drejtorinë për përfshirjen, për herë të parë, të personave me autizëm në një dokument zyrtar të Komunës, duke e vlerësuar këtë si një hap pozitiv. Ai propozoi që pika 1.8 e planit të ndryshohet, në mënyrë që shërbimet sociale ditore të ofrohen për të gjithë personat me autizëm dhe jo vetëm për të rriturit, me arsyetimin se numri më i madh i rasteve është te personat nën moshën 18 vjeçe. Musliu njëherësh kërkoi krijimin e një grupi të ri punues, të udhëhequr nga Drejtoria e Mirëqenies Sociale, me pjesëmarrje të ekzekutivit, legjislativit dhe organizatave joqeveritare që merren me këtë kategori, me qëllim hartimin e një plani më konkret të veprimit dhe strategjisë për mbështetjen e personave me autizëm dhe familjeve të tyre.

Nexhmije Gjema tha se ka mospërputhje në të dhënat statistikore të dokumentit, ku në një pjesë përmenden 8,735 biznese me 75,000 punëtorë, ndërsa më poshtë mbi 31,000 biznese me 205,000 të punësuar, prandaj kërkoj sqarim mbi bazën e të dhënave të përdorura për hartimin e planit. Ajo kritikoi mungesën e qartësisë në shpërndarjen e ndihmave sociale sipas numrit të anëtarëve të familjes dhe vlerësoi se shumata e parapara janë të pamjaftueshme dhe se dokumenti nuk paraqet gjendjen reale të Prishtinës, pasi mungojnë të dhëna konkrete për kapacitetet dhe stafin e Qendrës për Punë Sociale. Znj.Gjema tha se vërejtjet e dhëna në seancat e kaluara nuk janë përfshirë në versionin final të dokumentit, prandaj kërkoi rishikim të tij dhe vlerësoi se

dokumenti nuk krijon lidhje të qarta ndërmjet nevojave reale, projekteve, buxhetit dhe përgjegjësi për zbatim, duke lënë paqartësi edhe për financimin dhe implementimin nga komuna, donatorët apo OJQ-të.

Berita Abazi foli për çështjen e mungesës së një buxheti të qëndrueshëm për një plan trevjeçar, duke vlerësuar se financimi aktual është i kufizuar dhe i pamjaftueshëm për mbulimin e nevojave reale të qytetarëve të kryeqytetit. Ajo tha se problem shtesë mbetet fakti që një pjesë e madhe e shërbimeve sociale planifikohet të ofrohet nga OJQ-të dhe jo drejtpërdrejt nga Komuna, gjë që dobëson sistemin institucional të ofrimit të shërbimeve sociale. Znj. Abazi kërkoi krijimin e një sistemi më të fortë institucional me kontroll të brendshëm dhe përgjegjësi të qarta, duke theksuar se mbështetja e tepërt në OJQ-të mund të krijojë pasiguri në ofrimin e shërbimeve bazike. Ajo përmendi rastin e mbylljes së strehimores për fëmijë në Prishtinë si pasojë e tërheqjes së një OJQ-je, duke e konsideruar shqetësuese varësinë e Komunës nga organizatat joqeveritare për shërbime esenciale. Ajo rikujtoi propozimet e dhëna lidhur me objektivin për sigurimin e strehimit të mbrojtur për grupet në nevojë, duke potencuar se strehimorja e dedikuar për komunitetin LGBT është përfshirë në nënobjektiva, por mungon në matricën e aktiviteteve të planit.

Pika e pestë e rendit të ditës.

“Propozim-vendim për lënie në diskutim publik për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores, nr. 01-110/1205 (K.Pr), për shërbimin e transportit me “Merimangë” për territorin e komunës së Prishtinës”.

Luftar Braha tha se nevoja për ndryshim-plotësimin e Rregullores për shërbimin e transportit “Merimangë” vjen si rezultat i zhvillimit të kryeqytetit dhe ndryshimeve ekonomike, të cilat kanë ndikuar në rritjen e kostove dhe çmimeve, duke e bërë rregulloren aktuale joeficiente. Ai shtoi se ndryshimet synojnë ofrimin e një shërbimi më efikas, lirim të hapësirave publike dhe trotuareve, përmirësimin e rregullit në trafik, si dhe asistimin e Policisë dhe Inspektoratit të Kryeqytetit në ushtrimin më efikas të detyrave të tyre.

Kryesuesi konstatoi se “Propozim-vendim për lënie në diskutim publik për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores, nr. 01-110/1205 (K.Pr) për shërbimin e transportit me “Merimangë” për territorin e komunës së Prishtinës”, miratohet me dyzet e një vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim.

Pika e gjashtë e rendit të ditës.

“Propozim-vendim për lënie në diskutim publik për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores, nr. 01-030/01-236535/23 (K.Pr.) për organizimin dhe shfrytëzimin e parkingjeve të Komunës së Prishtinës”.

Luftar Braha tha se nevoja për ndryshim-plotësimin e kësaj rregulloreje vjen si rezultat i vendimit të Gjykatës Supreme dhe se qëllimi kryesor është përmbushja e kushteve të përcaktuara nga Gjykata Supreme, ndërsa gjatë dëgjimit publik pritet të diskutohen edhe çështje të tjera të rëndësishme, si qasja e banorëve në parkingjet pranë banesave, çmimet e parkingjeve në komunën e Prishtinës, si dhe kushtet për bllokimin ose bartjen e automjeteve.

Leutrim Retkoceri u shpreh në mbështetje të propozim-vendimit për lënien në diskutim publik të ndryshim-plotësimit të Rregullores për organizimin dhe shfrytëzimin e parkingjeve në Komunën e Prishtinës dhe tha se përveç adresimit të vendimit të Gjykatës Supreme, diskutimi publik të sjellë edhe rekomandime shtesë lidhur me çështjen e gjobave dhe konfiskimit të automjeteve. Retkoceri tha se nevojitet kreativitet më i madh për zgjidhjen e problemeve të parkingjeve, duke respektuar edhe Udhëzimin Administrativ për hartimin e akteve nënligjore, në mënyrë që rregullorja të rikthehet për votim e plotësuar me zgjidhje konkrete.

Gëzim Sveçla theksoi se emërtimi i kësaj pike është ndryshuar në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, pasi fillimisht ishte propozuar të kalonte për votim direkt në Kuvendin Komunal, gjë që sipas tij do të ishte në kundërshtim me ligjin dhe se mungesa e zyrtarëve ligjorë në mbledhjet e Kuvendit dhe të Komitetit për Politikë dhe Financa, është problem serioz për Komunën e Prishtinës. Ai tha se vonesa në trajtimin e kësaj rregulloreje lidhet me zhvillimet politike të vitit të kaluar dhe me aktgjykimin e Gjykatës Supreme, i cili sipas tij ka ndikuar drejtpërdrejt në funksionalitetin e ndërmarrjes “Prishtina Parking”. Ai shtoi se disa nga praktikrat aktuale të shqiptimit të gjobave janë zhvilluar jashtë bazës ligjore dhe kërkoi përgjegjësi për këtë situatë. Sveçla tha se gjatë diskutimit publik priten propozime shtesë për ta bërë rregulloren më funksionale dhe ritheksoi mbështetjen e Lëvizjes Vetëvendosje për funksionimin e ndërmarrjes “Prishtina Parking”, duke kërkuar që operimi i saj të jetë në përputhje me legjislacionin në fuqi. Ai konfirmoi se do ta mbështesin vënien në diskutim publik të rregullores.

Betim Abdullahu paraqiti shqetësimet për pagesat vjetore pa sigurim të parkingjeve, si dhe rastet kur ndërmarrja ka shfrytëzuar hapësira dhe hyrje të banesave pa zgjidhje adekuate për qytetarët. Prandaj, tha se kjo duhet të rregullohet në mënyrë që të sigurohen kushte më të mira si për banorët rezidentë, ashtu edhe për vizitorët e Prishtinës.

Endrit Zabërgja foli për nevojën që të rikujtohet konteksti i mandatit të kaluar gjatë hartimit dhe miratimit të kësaj rregulloreje, duke potencuar se shumica e asamblistëve kanë kontribuar në hartimin e saj përmes amendamenteve dhe propozimeve. Ai tha se përgjegjësia për situatën e krijuar nuk bie vetëm mbi ndërmarrjen “Prishtina Parking”, por edhe mbi Kuvendin Komunal si institucion përgjegjës për hartimin e rregullores. Zabërgja tha se edhe pas një viti nga aktgjykimi i Gjykatës Supreme, Kuvendi nuk ka arritur ta përmirësojë rregulloren, duke shprehur shpresën që raste të tilla të mos përsëriten në të ardhmen. Ai apeloj që gjatë hartimit të rregullores së re të ketë konsultime paraprake me juristë dhe ekspertë, në mënyrë që rregullorja të jetë në përputhje me ligjin dhe të shmangen anulimet nga gjykata.

Feim Osmani bëri të ditur se kishte qenë pjesë e votimit të rregullores së kaluar, por nuk e konsideron të drejtë që përgjegjësia për parregullsitë e konstatuara nga gjykata t’u atribuohet anëtarëve të Kuvendit. Ai shprehu habinë për mungesën e shqyrtimit paraprak nga Zyra ligjore, duke potencuar se rekomandimet dhe amendamentet do të duhej të verifikoheshin në aspektin juridik para miratimit dhe se gabimet mund të ndodhin gjatë votimeve të menjëhershme, sidomos duke pasur parasysh se jo të gjithë anëtarët janë juristë. Osmani kërkoi që kjo çështje të merret si vërejtje edhe për vendime të tjera, duke theksuar nevojën për prezencë dhe asistencë më aktive të zyrës ligjore në kuadër të Kuvendit.

Sokol Havolli tha se çështjet e ngritura nga vendimi i Gjykatës Supreme janë të rregullueshme dhe se gjykata ka dhënë udhëzime të qarta lidhur me autoritetin kompetent për bllokimin e automjeteve. Ai theksoi se Prishtina Parking nuk merr vendime për bllokim, por vetëm njofton Inspeksionin, ndërsa autoritet vendimmarrës janë Inspeksioni dhe Policia, siç përcaktohet edhe nga vendimi i gjykatës. Sipas tij, vendimi i Gjykatës Supreme e lehtëson trajtimin e kësaj çështjeje nga Kuvendi, pasi disa segmente të rregullores janë shfuqizuar dhe Kuvendi është udhëzuar t'i harmonizojë ato me kërkesat ligjore.

Gëzim Sveçla deklaroi se diskutimet duhet t'i shërbejnë përmirësimit dhe harmonizimit të rregullores së "Prishtina Parking". Ai kundërshtoi pretendimet se gjobat janë shqiptuar në mënyrë të rregullt nga inspektorët në terren, duke theksuar se ekzistojnë dëshmi dhe raportime që tregojnë praktika të tjera të funksionimit. Sipas tij, veprimtaria e ndërmarrjes është fokusuar kryesisht në shqiptimin e gjobave. Ai shtoi se Gjykata Supreme ka anuluar disa nene të rregullores, por nuk ka përcaktuar mënyrën konkrete të zgjidhjes së çështjeve, siç është forma e pagesave, duke kërkuar që diskutimet të jenë konstruktive dhe në funksion të përmirësimit të rregullores.

Sokol Havolli theksoi se çdo kontribut në diskutim, qoftë në cilësinë e ish-kryeshefit, drejtorit apo qytetarit, duhet të konsiderohet i dobishëm për procesin. Ai shtoi se Gjykata Supreme, përveç shfuqizimit të disa neneve, ka dhënë udhëzime të qarta për mënyrën e rregullimit të tyre. Sipas tij, shqiptimi i gjobave lidhet me zbatimin e rregullores së miratuar nga Kuvendi dhe duhet të zbatohet në mënyrë të barabartë. Havolli tha se synimi është hartimi i një rregulloreje funksionale dhe të ligjshme, që përmirëson qasjen në parking për banorët dhe siguron funksionalitetin dhe qëndrueshmërinë e ndërmarrjes.

Kryesuesi konstatoi se, "Propozim-vendim për lënie në diskutim publik për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores, nr. 01-030/01-236535/23 (K.Pr.), për organizimin dhe shfrytëzimin e parkingjeve të Komunës së Prishtinës, miratohet me katërdhjetë e dy vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim.

Pika e shtatë e rendit të ditës.

"Raporti konsolidues i performancës financiare dhe operative të ndërmarrjes "Prishtina Parking".

Endrit Zabërgja raportoi mbi gjendjen operative të ndërmarrjes "Prishtina Parking", duke theksuar se ndërmarrja fillimisht kishte funksionuar në mënyrë stabile, me trend pozitiv financiar, investime në digjitalizim dhe zgjerim të shërbimeve. Ai tha se pas vendimit të Gjykatës Supreme dhe mungesës së reagimit institucional për ndryshimin e rregullores, ndërmarrja u përball me rënie të konsiderueshme të të hyrave, kufizim të kompetencave, krijim të borxheve dhe vështirësi në pagesën e pagave dhe obligimeve ndaj punëtorëve. Sipas tij, ndërhyrja e mëvonshme përmes bashkëpunimit me Inspektoriatin ka sjellë stabilizim të pjesshëm dhe rritje të arkëtimit përmes SMS-ve, por ndërmarrja ende mbetet larg stabilitetit të mëparshëm financiar. Zabërgja tha se sfidat kryesore mbeten paqartësia ligjore, niveli i ulët i arkëtimit dhe borxhet operative dhe rekomandoi miratimin urgjent të një rregulloreje të re funksionale dhe të zbatueshme, sigurimin e mbështetjes financiare për ndërmarrjen, hartimin e një plani për

menaxhimin e borxheve, si dhe rritjen e transparencës dhe mekanizmave të kontrollit dhe arkëtimit.

Enver Redenica deklaroi se ndërmarrja “Prishtina Parking” po përballlet me krizë të rëndë financiare dhe organizative, duke akuzuar ish-menaxhmentin, menaxhmentin aktual dhe Komunën e Prishtinës për keqmenaxhim dhe keqpërdorim të parasë publike. Ai tha se ndërmarrja, e cila më parë gjeneronte të hyra të konsiderueshme, sot përballlet me mungesë likuiditeti, vonesa pagash dhe pasiguri për punëtorët. Ai tha se ka pasur parregullsi në menaxhimin e pagesave përmes SMS-ve, në trajtimin e banorëve rezidentë dhe në mënyrën e shqiptimit të gjobave. Njëherësh, ngriti shqetësime për marrëveshjen ndërmjet Komunës dhe ndërmarrjes “Prishtina Parking” lidhur me kompetencat e Inspektoriatit, duke pretenduar se modeli aktual i operimit është në kundërshtim me bazën ligjore. Redenica kërkoi auditim të plotë, hetim institucional për menaxhimin e ndërmarrjes, transparencë për kontratat dhe shpenzimet, si dhe mbrojtje të të drejtave të punëtorëve dhe garantim të pagave të tyre.

Feim Osmani u shpreh se vetë emërtimi i raportit është i paqartë, andaj kërkoj sqarime të detajuara lidhur me shpenzimet e ndërmarrjes, veçanërisht për investimin prej mbi 2.4 milionë euro në digjitalizim dhe pjesëmarrjen financiare të ndërmarrjes në këtë projekt. Sipas tij, kriza financiare e ndërmarrjes duhet të analizohet duke filluar nga menaxhimi i shpenzimeve dhe jo vetëm nga vendimi i Gjykatës Supreme. Ai foli edhe për shpenzimet e auditimit, shërbimeve juridike, marketingut dhe kontabilitetit, duke potencuar se ndërmarrja ka staf profesional të mjaftueshëm për mbulimin e këtyre funksioneve.

Çlirim Gërbeshi kritikoi raportin e ndërmarrjes “Prishtina Parking”, duke e cilësuar të paplotë, jo transparent për menaxhimin e miliona eurove, dhe ngriti dyshime për keqpërdorime financiare, përfshirë marrjen me qira të një hapësire private të lidhur me një mbështetës të LDK-së, si dhe shpenzimet për lizingun e veturave, që sipas tij kanë arritur rreth 160 mijë euro. Ai akuzoi ish-kryeshefin, Sokol Havolli, për keqpërdorim të veturës së ndërmarrjes dhe për shpenzime të tepërta reprezentative. Gërbeshi tha se sipas dokumenteve që i ka siguruar, vetëm në vitin 2024 janë shpenzuar mbi 16 mijë euro për ushqim dhe pije, ndërsa një drekë e vetme ka kushtuar 1,010 euro. Ai e cilësoi këtë si abuzim me paranë publike dhe kritikoi aksionarët për lejimin e këtyre veprimeve.

Sokol Havolli theksoi se projekti i digjitalizimit të parkingjeve në kryeqytet është një nga projektet më inovative, i realizuar përmes vendosjes së sensorëve tokësorë dhe tabelave digjitale që informojnë qytetarët për vendet e lira të parkingut. Sipas Havollit, projekti synon uljen e trafikut të shkaktuar nga kërkimi i parkingut dhe menaxhimin më efikas të stafit të ndërmarrjes “Prishtina Parking”. Ai tha se mbi 600 mijë euro janë investuar në këtë projekt nga ndërmarrja, ndërsa pjesa e mbetur nuk është paguar për shkak të rënies deri në 70% të të hyrave pas vendimit të Gjykatës Supreme, që ndikoi në funksionimin normal të ndërmarrjes. Havolli gjithashtu tha se shpenzimet për gazeta lidhen me obligimet ligjore për shpallje publike, shpenzimet juridike me tarifatat gjyqësore, ndërsa ato të auditimit me detyrimet ligjore për auditorë të brendshëm dhe të jashtëm. Në fund, ai i cilësoi disa nga akuzat e ngritura si gënjeshtër, duke thënë se nuk e sheh të nevojshme t’u përgjigjet.

Feim Osmani tha se është e qartë që nga obligimi prej 900 mijë eurosh për projektin e digjitalizimit, janë paguar rreth 600 mijë euro dhe se tani kuptohet edhe hendeuku financiar i ndërmarrjes. Sipas Osmanit, shpjegimet e dhëna janë të pamjaftueshme në raport me koston dhe benefitet që projekti i ka sjellë ndërmarrjes, duke shtuar se nuk është e qartë çfarë përfshin saktësisht ky investim.

Sokol Havolli theksoi se kontrata për projektin e digjitalizimit ka qenë publike dhe se të gjitha njësitet e kontraktuara janë transparente dhe të qasshme në platformën e “e-prokurimit”. Ai sqaroi se projekti nuk përfshin vetëm shtyllat “smart”, por edhe mijëra sensorë tokësorë dhe gjithë sistemin teknologjik që mundëson informimin dhe funksionimin e ndërmarrjes. Havolli tha se kontrata mund të prezantohet më detajisht në një rast tjetër, por theksoi se informacionet kanë qenë publike gjatë gjithë kohës.

Gëzim Sveçla tha se raporti për ndërmarrjen “Prishtina Parking” ka ardhur me vonesë dhe vetëm pas debatit për subvencionimin e ndërmarrjes, duke ngritur dyshime se ish-kryeshefi Sokol Havolli, vazhdon të ketë ndikim në menaxhimin e saj. Ai kritikoi raportin për mungesë projektesh zhvillimore dhe për fokusimin kryesisht te gjobat si burim performance. Sveçla tha se ndërmarrja ka monopol në menaxhimin e parkingjeve publike, por, megjithatë nuk është në gjendje të mbulojë pagat, sigurimet, qiratë dhe obligimet ndaj furnitorëve, duke e cilësuar këtë si pasojë të keqmenaxhimit të vazhdueshëm nga LDK dhe PDK në ndërmarrjet publike komunale. Sveçla kritikoi edhe vendimin për zhvendosjen e zyrave nga Pallati i Rinisë në objekte private të lidhura me donatorë politikë, si dhe projektin e digjitalizimit, për të cilin tha se ka pasur kosto të lartë pa rezultate konkrete për ndërmarrjen. Ai akuzoi gjithashtu “Prishtina Parking” se ka vazhduar t’i gjobisë qytetarët edhe pas aktgjykimit të Gjykatës Supreme dhe se rregullorja përkatëse ende nuk është sjellë në Kuvendin komunal.

Nexhmije Gjema tha se qytetarët po ndëshkohen dy herë, pasi hapësirat rezidenciale janë kthyer në parkingje publike, dhe tani po kërkohet edhe subvencionimi i ndërmarrjes nga qytetarët. Ajo kundërshtoi edhe pagesën e parkingut deri në orën 23:00 gjatë ditëve të punës, duke e cilësuar si të pajustificueshme për banorët që kthehen nga puna. Znj. Gjema ngriti dyshime për keqmenaxhim dhe keqpërdorime në “Prishtina Parking” dhe kërkoi rishikim të plotë të mënyrës së funksionimit të ndërmarrjes, duke theksuar se ajo duhej të ishte fitimprurëse për Komunën dhe jo të kërkonte subvencione.

Sokol Havolli tha se rregullorja e mëparshme parashihte pagesë të parkingut deri në orën 19:00, ndërsa zgjatja deri në orën 23:00 është bërë me kërkesë të banorëve rezidentë, për të adresuar problemin e parkimeve pa pagesë pas orës 19:00, që vështirësonin vendet e tyre të parkimit. Ai sqaroi se ndryshimi kryesor i rregullores ka qenë eliminimi i pagesës për banorët rezidentë dhe vendosja e pagesës vetëm për vizitorët, me qëllim lehtësimin e parkimit për banorët brenda lagjeve. Havolli shtoi se këto çështje mund të rishikohen në versionin e ri të rregullores, por ndryshimet janë bërë në bazë të kërkesave të banorëve.

Pika e tetë e rendit të ditës.

Raporti financiar buxhetor i kryeqytetit, (TM1) 2026.

Valbona Makolli paraqiti raportin financiar për periudhën janar–mars 2026, të përgatitur në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi. Ajo tha se të hyrat vetanake komunale kanë arritur në 5,202,381.59 euro, duke shënuar rënie prej 13.95% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2025, kryesisht si pasojë e vonesave në faturimin dhe arkëtimin e tatimit në pronë.

Shpenzimet buxhetore për këtë periudhë kanë arritur në 27,663,593.88 euro, apo 37.88% të buxhetit, ndërsa është raportuar rritje në kategorinë e pagave dhe mëditjeve për shkak të ekzekutimit të pagës së trembëdhjetë, si dhe rritje në mallra dhe shërbime, ndërsa realizimi i ulët i shpenzimeve kapitale është arsyetuar me funksionimin me sistemin “një e dymbëdhjeta” për shkak të mosmiratimit me kohë të buxhetit. Gjithashtu, drejtoresha tha se në raport janë përfshirë tabelat për realizimin e investimeve kapitale dhe rastet përmbartimore, sipas kërkesës së asamblesë.

Besa Shahini u shpreh se raportimet financiare nuk janë më vetëm çështje teknike, por kërkojnë edhe trajtim politik, veçanërisht lidhur me problemin e përmbartimeve në Komunën e Prishtinës. Ajo deklaroi se gjatë vitit 2025 rreth një e treta e buxhetit komunal, afërsisht 45 milionë euro, është shpenzuar për përmbartime, ndërsa një pjesë e konsiderueshme e këtyre mjeteve ka shkuar për shpenzimet e përmbartuesve. Besa tha se Komuna duhet të planifikojë dhe të ndajë mjete buxhetore për pagesën direkte të borxheve, në mënyrë që të shmangen procedurat përmbartimore dhe kostot shtesë. Ndonëse vlerësoi raportimin financiar si informues, ajo kërkoi që kryetari i Komunës të jetë i pranishëm në raportime të tilla, për të dhënë sqarime lidhur me menaxhimin e buxhetit dhe çështjen e borxheve komunale.

Feim Osmani tha se raporti financiar pasqyron performancë të dobët të qeverisjes në Kryeqytet, duke theksuar ngecje në realizimin e të hyrave dhe shpenzimeve kapitale, dhe kritikoi arsyetimin lidhur me mosrealizimin e të hyrave nga tatimi në pronë, duke theksuar se qytetarët presin kryerje me kohë të obligimeve administrative nga Komuna. Realizimi i shpenzimeve kapitale prej rreth 5%, është dukshëm më i ulët krahasuar me vitet paraprake, ndërsa një pjesë e konsiderueshme e mjeteve është tërhequr nga përmbartuesit. Feimi kërkoi më shumë transparencë dhe sqarime të detajuara lidhur me rritjen e shpenzimeve për mallra dhe shërbime, si dhe ngriti shqetësim për rritjen e numrit të të punësuarve me kontrata të veçanta, duke kërkuar sqarime për angazhimin dhe efektin e tyre në administratë.

Gëzim Sveçla shprehu shqetësim për mungesën e kryetarit dhe të drejtorëve gjatë shqyrtimit të raportit financiar, duke vlerësuar se kjo reflekton qasjen e qeverisjes lokale ndaj llogaridhënies. Ai foli për çështjen e rritjes së numrit të të punësuarve me kontrata për shërbime të veçanta, duke theksuar se numri i tyre është rritur nga 89 në 197 brenda katër muajve, përkatësisht me 108 persona më shumë. Sipas tij, kjo ka ndodhur në periudhë kur realizimi i investimeve kapitale është minimal dhe mungojnë projektet konkrete në terren. Sveçla kërkoi sqarime lidhur me angazhimin e këtyre personave nëpër drejtori të ndryshme, veçanërisht në Drejtorinë e Shëndetësisë, Drejtorinë e Sigurisë, të Kadastrit dhe Kabinetin e Kryetarit, si dhe kërkoi informata për koston financiare të këtyre kontratave dhe kategorinë buxhetore nga e cila mbulohen ato.

Bujar Gashi tha se punësimet në Drejtorinë e Shëndetësisë janë bërë në kuadër të dy projekteve të financuara përmes grantit specifik të Ministrisë së Shëndetësisë, të nisura nga viti 2023.

Projektet lidhen me kujdesin paliativ dhe kujdesin për gratë shtatzëna, lehonat dhe fëmijët nga mosha zero deri në tre vjeç. Ai theksoi se punësimet janë realizuar gjatë korrikut 2025, përmes procedurave të rekrutimit, ku përfshihen: mjekë, infermierë, logopedë, fizioterapistë dhe psikologë. Sipas tij, këto pozita janë të nevojshme për funksionimin e kujdesit parësor shëndetësor në Kryeqytet, duke pasur parasysh nevojat dhe ngarkesën ekzistuese në sistemin shëndetësor komunal.

Gëzim Sveçla ngriti dy çështje lidhur me sqarimet e dhëna për punësimet në Drejtorinë e Shëndetësisë. Ai foli për mospërputhje ndërmjet raportit financiar dhe deklarimeve të drejtorit, duke theksuar se sipas raportit numri i të punësuarve në fund të vitit 2025 ishte një, ndërsa në vitin 2026 rezultojnë gjashtëdhjetë punonjës. Sipas Sveçlës, kjo krijon përshtypjen se 59 persona janë punësuar gjatë tremujorit të parë të vitit 2026, ndryshe nga sqarimi se punësimet janë bërë në korrik të vitit 2025, ndaj kërkoi sqarim shtesë për këtë mospërputhje.

Valbona Makolli sqaroi se raporti paraqet krahasimin ndërmjet periudhës janar–mars 2025 dhe janar–mars 2026, ndërsa dallimi në numrin e të punësuarve reflekton gjendjen aktuale në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, duke shtuar se raportet TM1 dhe TM2 gjithmonë bazohen në krahasimin e periudhave të njëjta buxhetore ndërmjet viteve.

Bujar Gashi tha se pozitat kanë qenë të parapara edhe në qarkoren buxhetore të vitit 2025, ndërsa përfshirja e kategorive të tjera në udhëzimin administrativ ka ardhur si iniciativë e Ministrisë së Shëndetësisë.

Sokol Havolli theksoi se angazhimi i profesionistëve dhe ekspertëve është i domosdoshëm për funksionimin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe sqaroi se bëhet fjalë për profile profesionale, si inxhinierë ndërtimtarie, gjeodetë dhe arkitektë, të cilët mbulojnë nevojat teknike të drejtorisë.

Nexhmije Gjema shprehu shqetësim për proceset e konkurseve në Drejtorinë e Shëndetësisë, duke përmendur anulimin e një konkursi për dhjetë infermierë. Ajo tha se qytetarët kanë ngritur shqetësime për mungesë transparence dhe pretendime për parregullsi në rekrutim. Sipas saj, krijohet perceptimi se konkuret hapen dhe zhvillohet procesi i përzgjedhjes, por më pas anulohen, gjë që ngre dyshime për ndikime të jashtme dhe mungesë integriteti. Ajo kërkoi rritje të transparencës, hetim më të thelluar të rasteve dhe komunikim më të hapur me publikun për proceset e punësimit.

Fjolla Vukshinaj rikujtoi kërkesën e mëparshme për ridizajnimin e tabelave të raportimit buxhetor, duke propozuar që të përfshihen më qartë kategoritë, si projekti kapital, buxheti i planifikuar, pagesat për realizim, si dhe pagesat për vendime gjyqësore. Po ashtu, sugjeroi shtimin e kolonave për totalin e shpenzimeve dhe progresin e realizimit sipas thesarit, duke vlerësuar se kjo do të rrisë transparencën dhe mund të shërbejë si praktikë e mirë edhe për institucione të tjera.

Fadil Aliu foli për problemin me përditësimin e të dhënave për kontratat për shërbimet e veçanta në Komunën e Prishtinës, duke thënë se megjithë përditësimin financiar nga Ministria, numrat e punëtorëve civilë nuk janë përditësuar siç duhet, duke krijuar nevojën që një pjesë e fondeve të

mallrave dhe shërbimeve të ridrejtohet për pagesën e punonjësve vitalë për shërbimet e kryeqytetit.

Leonora Shabani pyeti se pse drejtori i Shëndetësisë deklaroi se janë punësuar logopedë dhe psikologë për programin e intervenimit të hershëm, nuk është bërë publik asnjë konkurs për këto pozita. Ajo theksoi se buxheti për këtë program është votuar vetëm në fillim të vitit 2026 dhe se shërbimet ende nuk ofrohen në qendrat e Mjekësisë Familjare, megjithëse programi parashihet të funksionalizohet në katër qendra në kryeqytet.

Bujar Gashi sqaroi për këtë, duke thënë se aktualisht janë të punësuar dy logopedë, një psikolog dhe tre fizioterapeutë në kuadër të programit të intervenimit të hershëm për fëmijë. Këto pozita janë paraparë me ligj dhe në qarkoren buxhetore të vitit 2025, për të cilën kishte qenë pjesë e takimeve për përgatitjen e saj. Sipas drejtorit, nga numri i përgjithshëm i pozitave të parapara në nivel vendi, katër profile i takojnë kryeqytetit dhe se këto punësime janë realizuar në të njëjtën kohë me punësimet për kujdesin paliativ dhe kujdesin për gratë shtatzëna, lehonat dhe fëmijët nga 0 deri në 3 vjeç.

Pika e nëntë e rendit të ditës.

Propozim-vendim për bartjen e mjeteve nga viti 2025 në vitin 2026”.

Valbona Makolli paraqiti bartjen e tejkallimit të të hyrave vetanake nga viti 2025 në vitin 2026, në vlerë totale prej 10,819,713.15 euro. Mjetet përfshijnë të hyrat vetanake të muajit dhjetor 2025 dhe të hyrat indirekte të TM4, si gjobat në trafik dhe gjobat e gjykatave. Znj. Makolli tha se mjetet janë ndarë në tri kategori: 60 mijë euro për paga dhe shtesa, 6,562,208 euro për mallra dhe shërbime, si dhe 4,191,504.27 euro për investime kapitale. Ajo theksoi se pagesat për mallra dhe shërbime lidhen me obligime dhe fatura të papaguara për shërbime të pranuar në fund të vitit 2025, për shkak të mungesës së buxhetit në vitin 2026. Ndërkaq, paga dhe shtesat kanë të bëjnë me pagesën e orëve shtesë për profesorët e shkollave profesionale, të cilat financohen nga të hyrat vetanake.

Feim Osmani shprehu pakënaqësi lidhur me mënyrën e planifikimit të bartjes së mjeteve nga tejkallimi i të hyrave, në vlerë prej 10.8 milionë euro, duke theksuar se pjesa më e madhe e tyre po destinohet për paga, medikamente dhe mallra e shërbime, ndërsa investimet kapitale po neglizhohen. Ai kërkoi sqarime shtesë për nevojën e këtyre shpenzimeve, duke theksuar se sipas raporteve financiare realizimi në këto kategori ka qenë pothuajse 100%. Ai deklaroi se nuk do ta kundërshtojnë bartjen e mjeteve, por propozoi që rreth 50 mijë euro të ndahen për rregullimin e parkut memorial për të zhdukurit me dhunë, i vendosur në kampusin universitar, duke e konsideruar këtë një çështje me rëndësi të veçantë për komunën dhe qytetarët.

Gëzim Sveçla kërkoi nga ekzekutivi të deklarohet lidhur me propozimin për ndarjen e mjeteve për krijimin e një kodi buxhetor për parkun memorial të të zhdukurve me dhunë nga Serbia, park i emëruar me votat e të gjitha grupeve në Kuvendin komunal. Ai tha se ndarja e mjeteve do të mundësonte vendosjen e një pllake përkujtimore me vlera artistike dhe historike, duke i dhënë formë institucionale parkut. Sveçla foli për mungesën e kryetarit, z. Përparim Rama, në

mbledhje, duke e cilësuar këtë si mungesë respekti ndaj Kuvendit komunal dhe grupeve politike, sidomos në një seancë ku diskutohet bartja e buxhetit me të cilin do të qeveriset.

Valbona Makolli sqaroi se bartja e mjeteve në Ministrinë e Financave bëhet për mbulimin e obligimeve ekzistuese që rrjedhin nga kontrata dhe se vlera e paraparë nuk është e mjaftueshme për të gjitha obligimet e Komunës. Ajo tha se këto mjete lidhen me projekte dhe pagesa të papërfunduara për shkak të mosmiratimit me kohë të buxhetit për vitin 2025, si dhe për të shmangur procedurat përmbarimore. Për parkun memorial, drejtoresha tha se çështja mund të diskutohet në kuadër të buxhetit të vitit 2026, pasi fillimisht duhet të trajtohen aspektet procedurale, përfshirë përcaktimin e hapësirës dhe mënyrën e realizimit të pllakës përkujtimore.

Feim Osmani tha se ekziston mundësia që 50 mijë euro të ndahen për parkun memorial të të zhdukurve, duke argumentuar se parku tashmë është emëruar nga Kuvendi dhe aspekti ligjor është i rregulluar. Ai tha se procedurat administrative mund të zgjidhen më vonë dhe se kërkesa është legjitime, e analizuar dhe lehtësisht e realizueshme, sidomos në prag të ditës përkujtimore për të zhdukurit. Në fund, Osmani kërkoi përgjigje të qartë nga ekzekutivi nëse propozimi pranohet apo jo.

Pas diskutimit të z. Osmani, përfaqësuesit e GP të VV-së e lëshuan mbledhjen.

Kryesuesi konstatoi se “Propozim-vendimi për bartjen e mjeteve nga viti 2025 në vitin 2026”, miratohet me njëzet e një vota për, zero kundër dhe një abstenim.

Pika e dhjetë e rendit të ditës.

Propozim-Vendim për dhënien e pronës së paluajtshme në shfrytëzim të pjesëve të parcelave kadastrale nr. P-71914059-06118-1 dhe P-71914059-06119-3 për NP “Termokos”, SHA.

Brahim Mehmetaj paraqiti kërkesën e ndërmarrjes publike “Termokos” për dhënien në shfrytëzim të një pjese të pronës komunale pranë Stadiumit “Fadil Vokrri”, me sipërfaqe prej 135 metra katrorë, për ndërtimin e një stacioni pompues në kuadër të rrjetit të ri të ngrohjes qendrore. Ai sqaroi se projekti synon sigurimin e presionit të nevojshëm në rrjetin e ngrohjes në zonën e Arbërisë, përkatësisht në rrugët “Stambolli” dhe “Toni Bler”. Sipas tij, pas verifikimeve dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, Drejtoria e Pronës ka propozuar dhënien në shfrytëzim të kësaj prone për afat 10-vjeçar, duke e konsideruar projektin në interes publik për rritjen e kapaciteteve dhe zgjerimin e sistemit të ngrohjes në kryeqytet.

Kryesusi konstatoi se, “Propozim-vendimi për dhënien e pronës së paluajtshme në shfrytëzim të pjesëve të parcelave kadastrale nr. P-71914059-06118-1 dhe P-71914059-06119-3 për NP “Termokos”, SHA, miratohet me njëzet e katër vota për, një kundër dhe asnjë abstenim ka kaluar edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Pika e njëmbëdhjetë e rendit të ditës.

Propozim-vendim për dhënien e pronës së paluajtshme në shfrytëzim të një pjese të parcelës kadastrale nr. P-71914059-07090-21 për NP “Termokos”, SHA;

Brahim Mehmetaj paraqiti kërkesën e ndërmarrjes publike "Termokos", për dhënien në shfrytëzim të një pjese të pronës komunale në oborrin e shkollës fillore "Naim Frashëri", me sipërfaqe prej 18 metra katrorë, për ndërtimin e një stacioni pompues shtytës. Ai sqaroi se projekti synon rregullimin e disnivelet të rrjetit, përmirësimin e furnizimit me energji termike dhe zgjerimin e rrjetit të ngrohjes në Lagjen e Muhaxhirëve dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, ka propozuar dhënien në shfrytëzim të parcelës për afat 10-vjeçar, duke e konsideruar projektin në interes të qytetarëve dhe zhvillimit të sistemit të ngrohjes në kryeqytet.

Nora Kelmendi diskutoi për dhënien në shfrytëzim të parcelës për ndërmarrjen "Termokos", duke theksuar se ajo duhet të ndahet fillimisht në dy pjesë, në mënyrë që një pjesë të mbetet pronë e Komunës. Ajo paralajmëroi se mosndarja mund të sjellë probleme juridike, duke përmendur si shembull rastin e Katedrales, dhe tha se dokumentacioni është i paplotë, pasi mungojnë skica e ndarjes dhe kopja e planit. Sipas saj, parcela nuk figuron as në listën e veçantë të pronave për dhënie në shfrytëzim, të miratuar nga Kuvendi komunal, prandaj pa përfshirjen në këtë listë ajo nuk mund të jepet në shfrytëzim.

Brahim Mehmetaj pranoi se dokumentacionit i mungon pjesa grafike, për shkak të mungesës të të dhënave të plota edhe në kadastrë, çka ka pamundësuar ndarjen e parcelës në këtë fazë dhe sqaroi se stacioni pompues është paraparë të vendoset në një objekt ekzistues të shkollës, i cili aktualisht nuk përdoret, dhe se për këtë ekziston dakordim me shkollën. Sipas z.Mehmetaj, çështjet tjera procedurale do të rregullohen me kohë.

Kryesuesi konstatoi se, "Propozim-vendimi për dhënien e pronës së paluajtshme në shfrytëzim të një pjese të parcelës kadastrale nr. P-71914059-07090-21 për NP "Termokos", SHA, miratohet me njëzet e gjashtë vota për, asnjë kundër dhe një abstinim.

Pika e dymëbëdhjetë e rendit të ditës.

Propozim-vendimi për lënie në diskutim publik për ndryshimet dhe plotësimin e Rregullores për menaxhimin e varrezave dhe objektit komemorativ në komunën e Prishtinës.

Kryesuesi sqaroi se këtë pikë të rendit të ditës e kemi elaboruar në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, së bashku me drejtoreshën Nora Cimili.

Rifadije Sopi tha se kjo çështje prek çdo familje në Prishtinë dhe kërkon ndërhyrje urgjente për shkak të mungesës së hapësirës, nevojës për dinjitet, modernizim dhe mirëmbajtje dhe Rregullorja ndihmon në shmangien e kaosit të mundshëm, duke vendosur standarde më të larta për shërbimet publike.

Kushtrim Sopa foli për nevojën urgjente për identifikimin e hapësirave të reja për varreza në Prishtinë, duke paralajmëruar se hapësirat ekzistuese në Arbëri, pranë xhamisë, janë drejt mbipopullimit dhe pritet të mbushen plotësisht brenda katër deri pesë viteve të ardhshme.

Rifadije Sopi tha se në kuadër të grupit të grave asambliste e kemi diskutuar dhe propozoi që gjatë shqyrtimit të ndryshimeve në rregulloren për menaxhimin e varrezave, të diskutohet edhe mundësia për krijimin e një hapësire të veçantë për varrezat e kafshëve.

Kryesusi konstatoi se “Propozim-vendimi për lënie në diskutim publik për ndryshimet dhe plotësimin e rregullores për menaxhimin e varrezave dhe objektit komemorativ në komunën e Prishtinës”, miratohet me njëzetë e pesë vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim.

Pika e trembëdhjetë e rendit të ditës.

Diskutim mbi situatën e krijuar të mbeturinave në Kryeqytet.

Kryesuesi konstatoi se nuk është paraqitur asnjë asamblistë për diskutim për këtë pikë të rendit të ditës.

Pika e katërbëdhjetë e rendit të ditës.

Propozim - vendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës për Muzeun e të mbijetuarave të dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë, i themeluar dhe i menaxhuar nga Fondacioni Jahjaga”.

Brahim Mehmetaj bëri të ditur se Drejtoria e Pronës ka qenë e angazhuar në trajtimin e çështjes dhe se kuvendarët janë pajisur me materialet përkatëse. Ai sqaroi se bëhet fjalë për dhënien në shfrytëzim të një objekti me sipërfaqe prej 183.66 metra katrorë, për afat 15-vjeçar, duke shtuar se për shkak të ndjeshmërisë së çështjes preferon që detajet relevante të trajtohen në mënyrë të kujdesshme.

Kryesuesi konstatoi se “Propozim vendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës për Muzeun e të Mbijetuarave të Dhunës Seksuale Gjatë luftës në Kosovë, i themeluar dhe i menaxhuar nga “Fondacioni Jahjaga”, miratohet me njëzetë e pesë vota për, një kundër dhe një abstenim.

Pika e pesëmbëdhjetë e rendit të ditës.

Propozim-vendimi për bartjen e normave aktuale nga niveli i arsimit të mesëm, të lartë dhe niveli i mesëm i ultë në nivelin parafillor.

Fadil Aliu sqaroi se, për shkak të mungesës së drejtorit, ka paraqitur pikën e rendit të ditës lidhur me plotësim-ndryshimin e një vendimi të mëparshëm, duke sqaruar se Ministria e Financave ka ndryshuar vazhdimisht numrin e normave të personelit, prandaj është vendosur të hiqet numri i saktë nga vendimi. Aliu tha se vendimi i ri parasheh që të gjitha normat nga shërbimi shkollor i mesëm dhe i lartë të kalojnë te institucionet parashkollore, pa specifikuar numër të saktë, për shkak të ndryshimeve të shpeshta në sistem.

Kryesuesi konstatoi se “Propozim-vendimi për bartjen e normave aktuale nga niveli i arsimit të mesëm, të lartë dhe niveli i mesëm i ultë në nivelin parafillor”, miratohet me njëzetë e gjashtë vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim.

Pika e gjashtëmbëdhjetë e rendit të ditës.

Diskutim mbi gjendjen e Ndërmarrjes Publike Banesore.

Leutrim Retkoceri theksoi se dy propozimet e paraqitura nga Lëvizja Vetëvendosje, lidhur me situatën e mbeturinave në kryeqytet dhe Ndërmarrjen Publike Banesore, nuk janë trajtuar siç duhet në seancë, pasi materialet e premtuara nuk janë sjellë dhe propozuesit nuk kanë qenë prezentë. Ai kritikoi këtë qasje si mungesë përgjegjësie dhe mospërmbyllje të zotimeve ndaj opinionit publik për çështje të rëndësishme për kryeqytetin.

Pika e shtatëmbëdhjetë e rendit të ditës.

Deklaratë për eliminimin e të gjitha formave të dhunës ndaj grave në politikë dhe jetën publike.

Rifadije Sopi paraqiti një deklaratë të Grupit të grave këshilltare të Kuvendit komunal të Kryeqytetit, duke kërkuar mbështetje për eliminimin e të gjitha formave të dhunës ndaj grave në politikë dhe jetën publike. Ajo theksoi se deklarata kërkon zero tolerancë ndaj dhunës, respektim të standardeve etike në media, eliminim të gjuhës së urrejtjes dhe stereotipeve, rritje të përfaqësimit të grave në vendimmarrje, si dhe forcim të kuadrit ligjor dhe institucional për parandalimin dhe ndëshkimin e dhunës.

Krysuesi konstatoi se “Deklaratë për eliminimin e të gjitha formave të dhunës ndaj grave në politikë dhe jetën publike”, miratohet me njëzet e gjashtë vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstinim.

Mbledhja përfundoi në orën 17:05.

Procesmbajtësi
Arton Brahim

Kryesues i Kuvendit
Fehmi Kupina

